



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xherxh Bush, Ndertesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesuese e KD-së  
Mr. Ardiana Bunjaku

Nr. Prot.: 4/912  
Datë: 18/12/2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, bazuar në nenin 13, paragrafi 1, pika 1.14, nenin 22, paragrafi 1, pika 1.3 si dhe nenin 65, paragrafi 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.12. 2018, mori:

### V E N D I M


- I. Themelohet Instituti për Bujqësi dhe Veterinari në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- II. Funksionimi i Institutit për Bujqësi dhe Veterinari do të bëhet pasi të miratohet Rregullorja nga KD-ja, përgjegjësitë dhe çështje si: fushëveprimtarisa, të hyrat, shpenzimet financiare, stafi i punësuar, qëndrueshmërinë e tjera duhet t'i përbaj Rregullorja që ta miratoj Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### A r s y e t i m

Duke pasur parasysh rolin e Institutit për Bujqësi dhe Veterinari, i cili themelohet në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, me qëllim të rritjes së konkurrencës, marrjen dhe menaxhimin e granteve të kësaj fushe, kryerjen e aktiviteteve hulumtuese, ofrimin e shërbimeve eksperimentale dhe shërbimeve klinike të veterinarisë, të gjitha këto në avancimin e kapaciteteve akademike dhe zhvillimin e sistemeve mësimore, të cilat e promovojnë mësimdhënien më efektive dhe më cilësore, në funksion të transformimit të UP-së në një universitet konkurrent me universitetet më të mira në rajon dhe në botë, Këshilli Drejtues i UP-së në parim pajtohet për themelimin e këtij instituti, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Vendimi t’iu dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Dekanit të FBV-së;
4. Zyrës Ligjore të UP-së;
5. Asistentes së KD-së;
6. Uebfaqes së UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Ardiana Bunjaku - kryesuese